



Zyra e Rregullatorit të Energjisë,

- Bazuar në autoritetin e dhënë nga Ligji 2004/9 “Për Rregullatorin e Energjisë”
- Në bazë të dispozitave të Ligjit 2004/8 “Për Energjinë”
- Në përmbushje të obligimeve ndaj direktivës 2001/77/EC të Traktatit të Komunitetit për Energji, dhe
- Në përmbushje të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 “Mbi Caqet Indikative për Konsumin e Energjisë Elektrike dhe Ngrohjes nga Burimet e Ripërtërishme dhe Bashkëprodhimi”
- Neni 5 i Vendimit të Qeverisë së Kosovës mbi “Masat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme dhe energjisë elektrike nga bashkëprodhimi në Kosovë për periudhën 2007-2013”

Me këtë raport konsultativ publikon propozimet për tarifën e përkohshme tentative të prodhimit të energjisë nga Hidrocentralet e vogla. Indikatorët që rezultuan në tarifën e publikuar përfshijnë parametrat

- (i) Faktori I Kapacitetit - CF
- (ii) Energjia e prodhuar - EP
- (iii) Kosto e Energjisë së Prodhuar - KEP
- (iv) Kosto e Kapitalit - KOK
- (v) Kosto Operacionale dhe e Mirëmbajtjes -KOM
- (vi) Vlera e Investimit Fillestar - VIF
- (vii) Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit - MPKK
- (viii) Jetëgjatësia ekonomike – JE
- (ix) Kosto e Ujit - KU



Tarifat janë rezultat i parimeve që përcaktojnë strukturat tarifore, kompatible me dispozitat ligjore në fuqi dhe duken si vijon:

<i>Kapaciteti i Instaluar</i>	<i>Çmimi (cent/kWh)</i>
<i>Hydrocentrale deri në 2 MW</i>	<i>6.44</i>
<i>Hydrocentrale nga 2 MW deri në 5 MW</i>	<i>5.02</i>
<i>Hydrocentrale nga 5 MW deri në 10 MW</i>	<i>4.02</i>

Ky raport konsultativ është publikuar si një mundësi për palët e interesuara që të paraqesin komentet e tyre, para se ZRRE të lëshojë vendim mbi tarifën e aprovuar. Deri më tani ZRRE nuk ka marrë asnjë vendim mbi aprovimin e Feed-In tarifave. Propozimet nga ZRRE janë preliminare dhe ofrohen vetëm si baze për tu komentuar nga palët e interesuara. Tarifën e propozuar janë të përkohshme dhe tentative, dhe mund t'i nënshtrohen shqyrtimeve të mëtejshme.

Afati i fundit për pranimin e komenteve mbi këtë Raport konsultativ është, deri me datën 26 Shtator 2008.

Komentet duhet të paraqiten me shkrim. Preferohet formati elektronik. Komentet e paraqitura me email duhet të dërgohen në [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org) me paragrafin e theksuar në lëndë/subjekt "Feed-in Tarifën Raporti Konsultativ – Komentet".

Komentet e shtypura (hard-copy) duhet t'i dërgohen ZRRE-së në zyret që gjenden në rr. Hamdi Mramori, Nr 1, 10000 Prishtinë të adresuara për "Departamentin e Çmimeve dhe Tarifave".